

RREGULLORE

Mbi

VEPRIMTARINE VALUTORE

Te Pergjithshme

Baza ligjore e kesaj rregullore eshte:

- a) neni 1, pika 4, shkronja "b", neni 12 shkronja "b", neni 43, shkronja "c" dhe neni 61, shkronja "b" e ligjit nr. 8269, dt.23.12.1997 "Per Banken e Shqiperise" i ndryshuar;
- b) neni 126, date 18.12.2006 "Per Bankat ne Republiken e Shqiperise", si dhe;
- c) "Rregullorja per veprimtarine valutore" e Bankes se Shqiperise miratuar me Vendim te Keshillit Mbikqyres nr.31, dt. 06.06.2007 dhe ndryshuar me vendimin nr 73, date 27.11.2007.

Objekt i kesaj rregullore jane veprimet valutore qe kryhen ne sportelet e Postes Shqiptare.

Subjekte te rregullores se Bankes se Shqiperise jane pjesmarresit dhe operatoret e tregut (nje prej te cileve Posta Shqiptare) ne veprimtarine valutore. Termat kryesore te perdorura ne aktivitetin valutor kane domethenien e meposhtme:

- a) "**Mjet pagese ne valute**" eshte çdo instrument monetar ne formen e kartmonedhes ose te monedhes metalike, çekut, kambialit, premtim pageses, leter kreditit dhe urdherave ose instrumentave te tjera te pageses.
- b) "**Valute**" do te kuptojme mjetet financiare ne formen e kartmonedhave, te monedhave metalike te huaja, te cilat kane kurs ligjor.
- c) "**Monedhe e konvertueshme**" eshte monedha lirisht e tregtueshme me nje monedhe tjeter ne tregun nderkombetar.
- d) "**Kurs Kembimi**" eshte çmimi relativ i nje monedhe te shprehur ne njesi te nje monedhe tjeter, ne nje date te caktuar.
- e) "**Veprimtari e kembimit valutor**" eshte veprimtaria e shitblerejes se valutave ne para fizike dhe te ceqeve te udhetareve ushtruar nga zyra e kembimit valutor ne emer dhe per llogari te saj ne menyre te vazhdueshme dhe per qellime fitimi.
- f) "**Zyra**" eshte ambjenti ne te cilin ushtrohet veprimtaria e kembimit valutor.
- g) "**Fature**" eshte dokumenti i leshuar nga zyra e kembimit valutor per çdo transakcion kembimi i cili permban:
 1. llojin e monedhes
 2. shumen dhe kursin e kembimit
 3. vleren e kembyer
 4. komisionin
 5. emrin, adresen dhe kodin fiskal te zyres
 6. numrin rendor te dokumentit.
- h) "**Bilanci ne valute**" eshte dokumenti ne te cilin hidhen te dhenat ditore per te gjitha transakcionet e kryera sipas informacionit te dhene ne fature.
- i) "**Tregu i kembimeve valutore**" eshte tregu ku kryhen veprimet e kembimit valutor.

Ne mbeshtetje te Nenit 60 te Ligjit "Per Banken e Shqiperise" vlera e lekut ne raport me valutat e tjera percaktohet lirisht ne treg, ne rast se Banka e Shqiperise nuk shpall kursin e lekut ne raport me valutat e tjera ose miraton ndonje rregjim tjetër te kembimeve valutore.

Operatoret e tregut te kembimeve valutore ne Republiken e Shqiperise jane:

1. Banka e Shqiperise
2. Bankat dhe Deget e bankave te huaja te licensuara nga Banka e Shqiperise
3. Zyrat e kembimit valutor te licensuara nga Banka e Shqiperise
4. Subjektet financiare jobanka qe kryejne veprimtari financiare te licensuara nga Banka e Shqiperise per te kryer veprimtari valutore, ne baze te rregullores "Per dhenien e licenses per te ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jobanka ne Republiken e Shqiperise".

Sporteli, Zyra e Finances, Filiali/Dega per llogari te saj mund:

1. te shese dhe te blej valute me para ne dore.
2. te shese dhe te blej valute nepermjet veprimeve ne llogari

Operatoret e tregut te kembimeve valutore, ne zbatim te nenit 65 te ligjit nr.8269, dt.23.12.1997 "Per Banken e Shqiperise" raportojne prane Bankes se Shqiperise.

Detyrat e specialistit te sherbimit ne Filial/Dege per veprimet e kembimeve valutore;

1. Zyra e kembimeve valutore duhet te filloje veprimtarine e saj brenda 1 muaji nga marrja e licenses.
2. Ndryshimet e personelit te sportelit te kembimeve valutore, t'i njoftohen Bankes se Shqiperise brenda 15 diteve per pajisjen e tyre me karte identifikimi. Per personat e larguar te dorezohet karta e identifikimit.
3. Te njoftoje Drejtorine e Sherbimeve Financiare ne Drejtorine e Pergjithshme te shoqerise per ndryshimin e adreses se zyres se kembimeve valutore te licensuar me qellim qe te njoftohet menjehere Banka e Shqiperise.
4. Te kontrolloje te gjithe punonjesit qe kane kontakt te vazhdueshem me klientet duhet te mbajne ne vend te dukshem karten e tyre te identifikimit.
5. Te afishoje ne vend te dukshem kursin ditor te kembimeve valutore, ne blerje e ne shitje per çdo valute.
6. Te kontrolloje qe per çdo kembim valutor, te leshohet fatura e veprimit te kembimit valutor te kryer dhe te mbahet nje kopje e tij. Ne kete dokument do te jene pasqyruar te dhenat sipas pozicioneve te pershkuara ne fature (bashkalidhur kopja e mandatit).
7. Te organizoje punen per realizimin ne kohe te raportimeve ditore dhe javore ne Drejtorine e Sherbimeve Financiare te Shoqerise.

Detyrimet e punonjesit ne sportel te ngarkuar me kembimet valutore:

1. Eshte pergjegjes per transaksionet e kembimit.
2. Per çdo kembim valutor te leshoje dokumentin per veprimin e kryer.

Klientit i jepet kopja e dyte e fatures se kembimit, origjinali i bashkengjitet pasqyres permblendhese ditore per Degen e Finances apo specialistin e Finances (te Filialit e Deges) dhe kopje e fundit mbahet ne arke. Ne faturen e kembimit te plotesohen sakte te dhenat per:

- Data, Ora
- Emri Mbiemri i individit qe kryen kembimin valutor
- Shumen per t'u konvertuar
- Kursin e kembimit

- Shuma e konvertuar
 - Firma e individit dhe e arketarit te sportelit
3. Rakordon veprimet per blerjet dhe shitjet ditore per çdo valute
 4. Respekton kriteret e percaktuara nga Filiali/dega per gjendjen e arkës.
 5. Raporton çdo dite me faks prane Drejtorise se Sherbimit Financiar ne Drejtorine e Pergjithshme per veprimet e kembimeve valutore te kryera si me poshte:
 6. Ne baze te evidencave ditore perpilon ate mujore per financen e Filialit/Deges dhe rakordon veprimet mujore me gjendjen e arkës.
 7. Perpilon evidenca progresive per transaksionet e kryera.

Raportimi ditor

Raportimi behet çdo dite brenda ores 14.30 ne Drejtorine e Sherbimeve Financiare. Ne te perfishihen te gjitha veprimet qe kryhen brenda 24 oreve te fundit. Posta Shqiptare perfshin ne kete raportim te gjitha veprimet e kryera ne filiale apo deget e tyre. Raportimi do te behet sipas Formularit 1.2 bashkangjitur.

Raportimi javor

Raportimi javor behet çdo te hene ne oren 09.00 prane Drejtorise se Sherbimit Financiar. Ne te perfishihen te gjitha veprimet e kryera ne qender te cilat jane raportuar çdo dite si dhe veprimet e kryera ne deget e Postes ne rrethe gjate javes se fundit. Raportimi behet ne leke dhe perfaqeson kundravleften e veprimeve ne valute te kryera gjate javes ne qender e dege. Raportimi pasqyrohet sipas formularit 3 bashkelidhur.

Transparenca

Posta Shqiptare gjate ushtrimit te veprimtarise ruan transparencen ndaj klientit duke:

1. afishuar ne nje vend te dukshem ne zyrat e saj licencen e marre nga Banka;
2. afishuar ne nje vend te dukshem ne zyrat e saj kurset e kembimit qe perdor per veprimtarine e kembimit valutore;
3. pajisja e klientit me fature per çdo transaksion kembimi valutore dhe sherbimi si agjent dhe ruan nje kopje te saj.

Parandalimi i pastrimit te parave dhe i financimit te terrorizmit

Posta Shqiptare gjate ushtrimit te veprimtarise valutore, vepron ne perputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne fushen e parandalimit te pastrimit te parave dhe luftes kunder financimit te terrorizmit, vecanerisht ne lidhje me:

- Identifikimin e klientit ;
- Ruajtjen e te dhenave mbi klientin dhe mbi transaksionet e kryera sipas afateve te kerkuara ;
- Raportimin prane autoriteteve perkatese per transaksionet e dyshimta dhe per transaksionet vlera e te cilave tejkalon kufirin e percaktuar nga ligji "Per parandalimin e pastrimit te parave".

Masat ndeshkimore

Banka kur konstaton se subjekti ka shkelur dispozitat e rregullores, merr masa ndeshkimore te cilat jane ne masen 20.000 (njezet mije) leke deri ne 100.000 (nje qind mije) leke kur konstaton se:

- a) Subjekti nuk zbaton dispozitat e ligjit "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- b) Subjekti nuk afishon licencen per ushtrimin e veprimtarise se kembimit valutore;
- c) Subjekti nuk ploteson kerkesat per ushtrimin e veprimtarise lidhur me kushtet teknike dhe te sigurise ne perputhje me aktet nenligjore te Bankes ;
- d) Subjekti nuk vepron ne perputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore ne lidhje me parandalimin e pastrimit te parave dhe luftes kunder financimit te terrorizmit ;
- e) Subjekti pa dijenin e Bankes ka ndryshuar te dhenat e tij mbi bazen e te cilave ai eshte licensuar nga Banka dhe nuk ka njoftuar Banken e Shqiperise per keto ndryshime.

Gjobat e percaktuara me siper paguhen per llogari te Bankes.

Pezullimi dhe revokimi i Licenses

Banka pezullon licencen e subjektit per 60 (gjashtedhete) dite kalendarike ne rast se ka prova te besueshme qe subjekti eshte perfshire ne aktivitete te pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit.

Banka e Shqiperise ka te drejten e revokimit te licenses ne rastet kur:

1. ne menyre te perseritur kryen shkeljet e parashikuara per masat ndeshkimore;
2. eshte perfshire ne aktivitete te pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit;
3. ka paraqitur dokumentacion te falsifikuar gjate procedures se aplikimit per licence ose gjate procedures se miratimit te veprimtarise shtese;
4. ka humbur kushtet ne baze te te cilave ai eshte licensuar ;
5. ushtron veprimtari te ndryshme nga veprimtaria per te cilen eshte licensuar dhe nga veprimtaria shtese ne rolin e agentit te miratuar nga Banka ;
6. nuk paguan gjobat e vendosura nga Banka si mase ndeshkimore ;
7. nuk fillon veprimtarine brenda 45 (dzyzetepese) diteve kalendarike nga marrja e licences;
8. nderpret veprimtarine per me teper se 60 (gjashtedhete) dite kalendarike;
9. nderpret veprimtarine me iniciativen e tij.

Ne rastin e revokimit te licences, subjekti dorezon ne Banke licencen dhe kartat identifikuese te kambisteve.

Pergjegjesi i finances per kontabilitetin

1. Eshte pergjegjes per pasqyrimin korrekt te veprimeve, ndjekjen e mbylljen e pozicionit te kembimit te Filialit/ Deges ne perputhje me limitet dhe udhezimet e Drejtorise se Posta Shqiptare sh.a.
 1. Kontrollon evidencat ditore dhe raportimet periodike per transaksionet ne kembim dhe mbylljen e pozicioneve.
 2. Organizon punen per grumbullimin e dokumentave respektive, ben kontrollin, çiftimin dhe kontabilizimin e veprimeve.

3. Ne rastet kur dokumentacioni nuk çiftoset njoftohet K/Deges, Drejtori i Filialit.
4. Te organizoje kontabilitetin ne perputhje me ligjin nr 7661 date 19.01.1993 "Per Kontabilitetin"

Kontabilizimi

Posta Shqiptare e licensuar per ushtrimin e veprimtarise valutore:

1. organizon dhe mban kontabilitetin ne formen e percaktuar ne ligji «Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare» ;
2. mban libra arke per çdo monedhe;
3. mban bilancin valutor
4. llogarit pozicionin e hapur nga kembimi valutor ne fund te çdo dite.

Per te dhene nje ide me te qarte mbi kontabilizimin e veprimeve konkretizojme me nje shembull konkret:

1. Arka x merr furnizim nga arka e filialit, deges 500Euro dhe 100.000 leke.

Eurot e furnizuar kane qene gjendje ne arken e filialit/deges me kursin e fundit te nje dite me pare 121.8

Ne kete rast:

Per veprimet me euron

Debi : Arka valute (analize kodi punonjeses)	500 (121.8)		x
Kredi : Arka valute e Filialit	x		500 (121.8)

Per veprimet ne leke

Debi : Arka ne leke (analize kodi punonjeses)	100.000		x
Kredi : Arka ne leke Filialit	x		100.000

2. Gjate dites u blene 800 euro dhe u shiten 700 euro. Kursi nga Drejtoria Sherbimeve Financiare eshte 121.8 ne blerje dhe 122.7 ne shitje.

Evidenca ditore e vlefshme per kontabilizimin qe do te perpilohet nga punonjësja do te jete:

Nr.	Monedha	blerje	kursi	leke	shitje	kursi	leke	dif.shitje-blerje	≠ gjedj.	Rezult	
								valute leke			
1	2	3	4	5	6	7	8	9(3-6)	10(5-8)	11(9*kursi)	12(10-11)
1	EUR	800	121.8	97440	700	122.7	85890	100	11550	12180	-630

Ne rastin konkret gjate dites jane kryer veprime blerje me teper se sa jane shitur. Pra nga gjendja eshte bere blejre 100 Euro e cila figuron ne kontabilitet me kursin 121.8 leke.

Per kete do te behet kontabilizimi per shtimin e gjendjes se arkës ne valute dhe pakesimin e gjendjes se arkës ne leke.

Ne kete rast :

Per veprimet ne euro;

Debi : Arka valute (analize kodi i punonjeses)	100 (100*121.8)		x
Kredi : Xhirim llogari 581te	x		100 (100*121.8)

Per veprimet ne leke;

a- Debi : Xhirim Ilogari 581	12180	x
Kredi : Arka ne leke (analize kodi i punonjeses)	x	12180
b- Debi : Te ardhura	630	x
Kredi : Arka ne leke (analize kodi i punonjeses)	x	630

Pra, gjendja ne fund te dites per valuten do te jete: $500 + 100 (800 - 700) = 600$ Euro

Per lekete do te jete: $100.000 + 12180 - 630 = 111550$ leke

Sqarojme se kontabilizimi me siper pasqyron veprimet e çdo dite bazuar ne mandate hyrje dalje qe tregojne ne rastin e permendur pakesim te arkes valute apo shtese te gjendjes se arkes leke. Peveç pasqyres ditore dhe permbljedheseve progresive javore qe do te raportohen ne Drejtorine e Sherbimeve Financiare, pasqyra me siper, per efekte te rakordimit me kontabilitetin do te mbartet ne pasqyra mujore. Keshtu po supozojme se permbljedhesja mujore do te permbaje:

1	2	3	4	5	6	7	8	dif.shitje-blerje Valute leke		≠ gjedj. leke	Rezult leke
1	2	3	4	5	6	7	8	9(3-6)	10(5-8)	11(9*kursi)	12(10-11)
1	EUR	800	121.8	97440	700	122.7	85890	100	11550	12180	-630
2	--	500	121.9	60950	500	122.8	61400	0	-450	0	-450
3	--	700	121.4	84980	800	122.3	97840	-100	-12860	-12140	-720
		2000	121.7	243370	2000	122.6	245130	0	-1760	+40	-1800

Siç shihet ne kete rast muajin e marre si shembull del se:

- 1- Gjate muajit jane blere dhe shitur valute (Euro) ne shuma te barabarta.
- 2- Kemi blere 100 Euro nga gjendja ne rastin (1) me kurs 121.8 leke/ 1 Euro dhe kemi shitur 100Euro me shume ne rastin (3) me kurs 122.3 leke/ 1Euro.

Te ardhurat nga konvertimi ne fund te muajit per kete arke do te rezultojne 2260 leke dhe kjo rezulton nga kontabilizimi i pasqyrave ditore.

Per gjendjen ne euro te arkes qe ne rastin tone mbetet gjendja e furnizimit fillestar pasi gjate muajit veprimet shitje-blerje rezultojne te barabarta, do te rivleresohet me kursin e kontabilitetit per fundin e muajit perkates, duke cuar diferencen ne te ardhura ose shpenzime konvertimi nga rivleresimi kjo ne varesi te kursit. Ky kurs do t'i behet e ditur sportelistes se zyres se kembimit pasi do te jete kurs referimi per veprimtarine e muajit ne vijim.

Rregullorja e meparshme e kembimit valutor miratuar me vendim drejtorie nr.219, dt.24.09.2002, shfuqizohet.

ARQILE GOREA

DREJTOR I PERGJITHSHEM